



1204	699
2	09.12.11

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije
Ministry of Trade and Industry

Komisioni Disiplinor / Diciplinska Komisija/ Disciplinary Board

Komisioni Disiplinor bazuar në nenin 71 nënparagrafët 1.1, 1.2, 1.3, nenin 66 nënparagrafi 3.1. të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës, si dhe Rregulloren Nr 04/2011 për procedurat disiplinore në shërbimin civil, në Seancën dëgjimore të mbajtur me 27.11.2011, nxjerr këtë:

V E N D I M

Nëpunësi civil znj. Valdete Halimaj për shkak të shkeljes së rëndë të paraparë në Rregulloren Nr 04/2011 për procedurat disiplinore në shërbimin civil Neni 6 pika 1.10 shkelja e detyrave të punës që kanë pasoja për palën dhe organin e lartë shtetëror dhe pika 1.15 kryerja e aktiviteteve që bien ndesh me interesat e institucionit dhe organet e tjera shtetërore. Me ç'rast komisioni ka vendosë që znj. Valdete Halimaj të shqiptohet masa e parapare sipas nenit 8 pika 1.4 i Rregullosës Nr 04/2011 për procedurat disiplinore në shërbimin civil:

Ndërprerja e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil nga komisioni disiplinor pa dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension

Me hyrjen e këtij vendimi në fuqi, shfuqizohet vendimi për pezullim nr. 670 i datës 09.11.2011.

A r s y e t i m

Vendimi është marrë bazuar në shkresat e lëndës si dhe pas shqyrtimit të të gjitha provave veç e veç si dhe shqyrtimit të materialeve të pranuar nga raporti i lëndës 2011/4, shkresës zyrtare të Sekretares së Përgjithshme, raportit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm në MTI me numër ref. 677 i datës 11.11.2011, të gjeturat nga inspektorati i tregut i MTI-së dhe poashtu materialet e dalura nga seanca dëgjimore mbajtur me datën 07.12.2011.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshillë Juridike:

Pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Komisionin për ankesa pranë MTI-se në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të Vendimit, ankesa dorëzohet përmes DAQ-se / Divizionit të Personelit.

Vendimi i dorëzohet:

Znj. Valdete Halimaj

Sekretarit të Përgjithshëm të MTI-se
Personelit
Arkivit

Anëtarët e Komisionit Disiplinor

1. Irfan Lipovica - kryesues
2. Gazmend Mejzini - anëtar
3. Lebibe Haliti - anëtare





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

06	04	2
SHKËMBIM	6/14/2012	113

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBËR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

02/11/2012	1619
3	13 04 12 1302/36/2012

Këshilli i Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji i Këshillit në përbërje: Irena Svetiq Ahmedi kryetare, Bajram Zogiani dhe Sabile Avdyli anëtarë, pas shqyrtimit të ankesës nr. 269/2012 të datës 29.02.2012 të parashtruar nga ankesja Valdete Halimaj, me vendbanim në Tashlihe IV rr. Naser Hajrizi nr. 12, Prishtinë, në çështjen juridike ndërprerje e marrëdhënies së punës, nga organi i punëdhënës-Ministrisë e Tregtisë dhe Industrisë, duke vepruar në pajtim me nenin 10 parag. 1 pika 1.1, nenin 12 parag. 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 129 paragrafi 129.3 të Ligjit nr. 02/L-28 të Ligjit për Procedurën Administrative dhe në pajtim me Rregulloren nr. 02/2011 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Kolegji i Këshilli, në seancë jopublike, të mbajtur më datë 05.04.2012 mori këtë:

V E N D I M

I. Kthehet në rishqyrtim dhe vendosje Komisionit për zgjedhjen e kontesteve dhe të ankesave, -Ankesa nr. 15 e datës 04.01.2012, e parashtruar nga ankesja Valdete Halimaj.

II. OBLIGOHET, organi i punësimit-Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, që në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi, t'a rishqyrtojë ankesën e përmendur në Komisionin për zgjedhjen e kontesteve dhe ankesave dhe duke respektuar rregullat dhe procedurat ligjore të merr vendimin meritor për këtë çështje.

A r s y e t i m

Ankuesja, Valdete Halimaj i punësuar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, në pozitën zyrtare ligjore për licencim, me vendimin nr. 699 të datës 09.12.2011, Komisioni disiplinor i shqipton masën disiplinore ndërprerja e marrëdhënies së punës në shërbimin civil pa dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension. Ankuesja i pa

kënaqur më këtë vendim, paraqet ankesë nr. 15 më datë 04.01.2012 në Komisionin për zgjedhjen e kontesteve dhe të ankesave në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

Komisioni për zgjedhjen e kontesteve dhe të ankesave në Ministrinë Tregtisë dhe Industrisë ka refuzuar ankesën si të pa bazuar, pa arsyetimin e vendimit, ankuesja ka paraqitur ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se komisioni disiplinor ka nxjerr vendim kundërligjshëm, pa argumentuar dhe pa prova të besueshme.

Kolegji i Këshillit kompetent për vendosjen e kësaj çështjeje, në bazë të dispozitës së nenit 10 paragraf 1.1, neni 12 paragraf 12.2 i Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe dispozitave ligjore në fuqi ka shqyrtuar të gjitha shkresat parashtruara të lëndës, ka vërtetuar se ekziston baza ligjore për të vendosur, duke e obliguar Organin e Punësimit që ta ri-shqyrtojë ankesën e ankueses të paraqitur në Komisionin për zgjedhjen e kontesteve dhe ankesave të organit të punësimit për këto arsye:

Dispozitivi i Vendimit të Komisionit për zgjedhjen e kontesteve dhe ankesave Ministrisë Tregtisë dhe Industrisë nr. 366 të datës 03.02.2012 është i pa qartë, po ashtu vet arsyetimi i vendimit është në kundërshtim me nenin 85 Arsyetimi i aktit, paragraf 85.1. i Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 02-L-28, ku thotë: "Përveç rasteve kur ligji vetë parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsye për të gjitha ato akte të cilat pjesërisht ose tërësisht: a) mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në ndonjë mënyrë tjetër të drejta dhe interesa ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime;", si dhe nenin 86, paragraf 1 dhe 86 paragraf 3 cili thotë se: "Arsyetimi duhet të formulohet qartë dhe të përfshijë shpjegimin e bazës ligjore dhe faktike të aktit. Arsyetimi me të dhëna të paqarta, kontradiktore ose të pasakta, është i barasvlershëm me mungesën e arsytimit."

Kolegji konkludon se vendimi nuk përmban elementet dhe informacionet e nevojshme të Aktit Administrativ siç është përcaktuar me nenin 84 të këtij Ligji. Kolegji i Këshillit konstaton se për këtë arsye duhet të kthehet në rishqyrtim dhe vendosje Komisionit për zgjedhjen e kontesteve dhe të ankesave në Ministrinë Tregtisë dhe Industrisë, ankesa e ankueses Valdete Halimaj ndaj vendimit të Komisionit Disiplinor.

Komisioni për zgjedhjen kontesteve dhe ankesave i Ministrisë Tregtisë dhe Industrisë, me rastin e shqyrtimit të ankesës së Valdete Halimaj, duhet me arsyeton shkeljet e supozuara më faktet dhe provat dhe të nxjerr vendim meritore dhe të drejtë, duke vërtetuar se a janë shkeljet disiplinore të argumentuar nga ana e Komisionit Disiplinor.

Duke u bazuar në faktet dhe provat e cekura më lartë, pa u lëshuar në përmbledhjen e veprimeve të tjera, Kolegji i Këshillit ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi i Këshillit paraqet vendimin administrativ të formës së prerë. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pa kënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit

nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit 30 (tridhjetë) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i Konfliktit Administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit

T'i dorëzohet: Ankueses, Valdete Halimaj , Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë , Menaxherit të Personelit në MTI dhe Dosjes së lëndës ankimore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda nr. 02 (36) 2012, më 05.04.2012.



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLICA E KOSOVO QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO	
Nr. Post. Spec. Post. Pro. No.	366
Nr. Klasifikimi Klasifikimi	-02-
Nr. Dokumenti Dokumenti	0302/12
Primiti ditën / s.	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry
Komisioni i Ankesave - Komisija za Žalbe - Commission of Clamour

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, në mbështetje të nenit 136 paragrafi 1 nënparagrafi a) të Ligjit Nr.02/L-28 Për Procedurën Administrative, nenit 82 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-149 Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 9 paragrafi 7 të Rregullores Nr.05/2011 Për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, shqyrtoi Ankesën Nr.15 të datës 04.01.2012 të Valdete Halimaj, kundër Vendimit Nr.698 të datës 09.12.2011 të Komisionit disiplinor, në seancën dëgjimore të mbajtur me datën 18. Janar 2012, dhe takimin e serishëm me datën 27 Janar 2012, morri këtë:

V E N D I M

1. HIDHET POSHTË Ankesa Nr.15 të datës 04.01.2012 e z. Valdete Halimaj kundër Vendimit Nr.699 të datës 09.12.2011 të Komisionit disiplinor, si e pabazë.
2. VËRTETOHET Vendimi Nr. 699 të datës 09.12.2011, i nxjerrur nga Komisioni disiplinor si i bazuar.

A r s y e t i m




Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave shqyrtoj Ankesën Nr.15 të datës 04.01.2012 e Valdete Halimaj kundër Vendimit Nr.699 të datës 09.12.2011 të Komisionit disiplinor në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe të gjitha provat veç e veç, vërtetohet se Vendimi i komisionit disiplinor është i bazuar për Ndërprerjen e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil dhe refuzoj Ankesën si të pa bazë të palës ankuese.

Nga kjo u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

UDHËZIM JURIDIK: Kundër vendimi të Komisionit pala e pa kënaqur ka të drejtë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, brenda afatit prej 30 ditëve prej datës së pranimit të vendimit me shkrim drejtpërdrejt apo me anë të postës-urgjent.

Anëtarët e Komisionit të Ankesave

1. Hafiz Gara / Kryesues
2. Nexhmije Shala / Anëtare
3. Fadil Mustafa / Anëtarë

Vendimi i dorëzohet:

- Valdete Halimaj;
- Sekretares së Përgjithshme të MTI-së;
- DAQ-re/ Divizionit të Personelit;
- Komisionit të Ankesave dhe
- Arkivës në MTI-jë.



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO	
MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIE - MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY	
Hiqja Org. Org.Jedites Org.Unit	KOM
Nr. i tanem Regjistrimi Për Regjim	3
Nr Prot. Breg. Prot. Prot. No.	1755
Data Udhim. Data	27.04.12
Pristinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry
Komisioni i Ankesave - Komisija za Žalbe - Commission of Clamour

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, në mbështetje të nenit 136 paragrafi 1 nënparagrafi a) të Ligjit Nr.02/L-28 Për Procedurën Administrative, nenit 82 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-149 Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 9 paragrafi 7 të Rregullores Nr.05/2011 Për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, Vendimit A 02/36/2012 datë 06.04.2012 Të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shqyrtoi Ankesën Nr.15 të datës 04.01.2012 të Valdete Halimaj kundër Vendimit Nr.699 të datës 09.12.2011 të Komisionit disiplinor, në seancën e mbajtur me datën 27.04.2012, morri këtë:

V E N D I M

1. REFUZOHET SI E PABAZUAR Ankesa Nr.15 të datës 04.01.2012 e Valdete Halimaj kundër Vendimit Nr.699 të datës 09.12.2011 të Komisionit disiplinor.
2. VËRTETOHET Vendimi Nr. 699 të datës 09.12.2011, i nxjerrur nga Komisioni disiplinor si i bazuar.

A r s y e t i m

Komisioni për zgjidhjen e kontesteve dhe Ankesave pas marrjes së Vendimit A 02/36/2012 datë 06.04.2012 Të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rishqyrtoj ankesën Nr.15 të datës 04.01.2012 të Valdete Halimaj kundër Vendimit Nr.699 të datës 09.12.2011 të Komisionit disiplinor në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe të gjitha shkresat lidhur me lëndën e lartpërmendur dhe VËRTETOJ se Vendimi i komisionit disiplinor është i bazuar për Ndërprerjen e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil dhe refuzoj Ankesën si të pa bazë të palës ankuese.

Për shkak se :

- Znj. Valdete Halimaj si zyrtare ligjore për licenca ka vepruar në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësit e saj të punës dhe me Ligjin nr.2004/05 Për tregtinë me naftë dhe derivate

të naftës, me Ligjin nr.03/L-138 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/05 Për tregtimin me naftë dhe derivate të naftës, Për lëshimin e lejeve të importit, ku në asnjë dispozitë ligjore nuk ceket fjala leje importi, derisa neni 5 paragrafi 2 të Ligjit nr.03/L-138 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/05 thotë se: Zyra e Licencimit do të shqyrtojë dhe marrë vendim për pajisjen me licencë për veprimtari në sektorin e tregtimit dhe përpunimit të naftës dhe derivateve të naftës. Lëshimi i lejeve është bërë pa bazë ligjore (bashkangjitur keni një kopje të lejes së importit).

- Ankuesja z.nj. Valdete Halimaj jo vetëm që nuk ka pasur të drejtë të lëshoj leje importi por ka lëshuar leje importi pa autorizim zyrtar me shkrim nga drejtori z.Ramadan Euzhala i cili vetëm me telefon e ka autorizuar që të lëshojë leje importi (sipas procesverbalit nr.697 datë 09.12.2011 faqe 3 pika 4 e parafundit të faqes, dhënë nga znj. Valdete Halimaj)
- Z.nj. Valdete Halimaj (deklaruar në procesverbalin e komisionit disiplinor nr.697 datë 09.12.2011 faqe 3 pika 6 e parafundit të faqes) i ka shkel dispozitat ligjore të "U.A. Nr. 07/2010 "Për përcaktimin e produkteve të naftës dhe derivateve të saj, procedurës së licencimit dhe llojet e licencave për subjektet që ushtrojnë veprimtari në sektorin e naftës" ku thotë se "Zyra e licencimit mundet që në bashkëpunim me inspektoratin e tregut të ushtroj kontroll të subjektet e licencuara, por pasi kjo nuk ka qenë e mundur ne kemi dal ne teren dhe kemi vizituar subjektet pa inspektoratin". Udhëzimi e parasheh bashkëpunimin me inspektoratin, mirëpo nuk ju lejon që zyra e licencimit të dal ne teren për ti vizituar subjektet pa inspektoratin.

Sa i përket ankesës Nr.15 të dates 04.01.2012 të arsyetimit të z.nj. Valdete Halimaj për shkelje esenciale të procedurës refuzohet si e pabazë për arsye se:

- Neni 5 të Rregullores Nr.05/2011 Për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, parasheh që Komisioni i Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave themelohet në kuadër të çdo institucioni qendror dhe komunal ku janë të punësuar nëpunësit civil në këtë komision duhet të përfaqësohet diversiteti gjinor dhe një anëtar të zgjidhet ku ka njohuri për fushën ku është bërë shkelja. Në këtë rast anëtarja e tretë të komisionit ad hoc i ka të drejtat e barabarta në vendim marrje sikur se anëtarët e tjerë të komisionit.
- Procesverbalin i mbajtur në seancën e komisionit disiplinor për hir të transparencës është mbajtur edhe me diktafon (këtë mund ta kërkon ankuesja nëse dyshon në procesverbal).

Në konstatimin jo të plotë të gjendjes faktike:

Ankesa e Z.nj. Valdete Halimaj hidhet poshtë sepse Sekretarja e përgjithshme e MTI-së vendimin për pezullimin, e ka marrë konform nenit 63 paragrafi 1 të Ligjit 03/L-149 "Për shërbimin civil të Republikës së Kosovës", ku thuhet se : "Nëpunësit civilë do t'u nënshtrohen masave disiplinore për shkelje të detyrës, që ka ndodhur si rezultat i fajit të tyre, sikur që është përcaktuar me këtë ligj" dhe nenit 65 të këtij ligji ku citohet se : 1. Nëpunësit civilë janë përgjegjës për të gjitha dëmet e shkaktuara qytetarëve ose institucionit gjatë ushtrimit të detyrës si rezultat i paafësisë

profesionale, neglizhencës së rëndë ose veprimeve të qëllimshme, të paligjshme. 2. Pas përcaktimit të përgjegjësisë, do të bëhet sanksionimi i nëpunësit civil, i cili i ka shkaktuar dëm institucionit ose qytetarëve.

Vendimi për pezullimin nga Sekretarja e përgjithshme e MTI-së si organi më i lartë i shërbyesve civil, është marrë me qëllim që të mos të vazhdohet me shkelje derisa rasti i Z.nj. Valdete Halimaj të procedohet në komisionin disiplinor konform procedurave ligjore në fuqi.

Nga kjo u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

UDHËZIM JURIDIK: Kundër vendimi të Komisionit pala e pa kënaqur ka të drejtë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, brenda afatit prej 30 ditëve prej datës së pranimit të vendimit me shkrim drejtpërdrejt apo me anë të postës-urgjent.

Anëtarët e Komisionit të Ankesave

1. Hafiz Gara / Kryesues
2. Nexhmije Shala / Anëtare
3. Selvije Qekaj / Anëtare

Vendimi i dorëzohet:

- Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës,
- Z.nj. Valdete Halimaj;
- Sekretares së Përgjithshme të MTI-së;
- DAQ-re/ Divizionit të Personelit;
- Komisionit të Ankesave dhe
- Arkivës në MTI-së.



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
 KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
 MINISTRI I TREGTISË DHE INDUSTRIE SË KOSOVËS-INDUSTRIE MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY

Pranuar / Dorëzuar Prizvano / Predato Received / Delivered	14-06-2012	28	2	god year
Organ / Shkëmbim Organ / Jedinstvo Org. / Unit	Nr. Prot. Nr. Prot. Prot. No.	Shënime Prilog Appendix	Vlerësimi Kuantiteti Quantity	
SUPPISHKË	1132/2012			

Prishtinë / a

Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A 02/126/2012

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje: Irena Svetiq Ahmedi, kryetare, Bajram Zogiani dhe Sabile Avdyli-anëtarë të Kolegjit për të vendosur në objekt të ankesës nr. 915/2012 të datës 21.05.2012 për nxjerrjen e vendimit përfundimtar lidhur me ankesën e parashtruar nga Valdete Halimaj nga Prishtina, me vendbanim në Taslixhe IV rr. Naser Hajrizi nr. 12, në çështjen juridike ndërprerje e marrëdhënies së punës, nga organi i punëdhënës-Ministrisë e Tregtisë dhe Industrisë. Kolegji i Këshillit duke vepruar në pajtim me nenin 10 paragraf. 1.1, nenin 12 paragraf. 2 dhe nenin 13 të Ligjit nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 14 paragrafi 1 nën-paragraf. 1.1 të Rregullores nr. 02/2011 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillë, në seancën jo-publike, më datën 13.06.2012, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa nr. 915/2012, të datës 21.05.2012, të paraqitur nga Valdete Halimaj nga Prishtina dhe mbeten në fuqi Vendimi i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave nr. 1735 të datës 27.04.2012 dhe Vendimi i Komisionit disiplinor nr. 699 , të datës 13.12.2011, me të cilën, ankueses i është shqiptuar masa disiplinore ndërprerje e marrëdhënies së punës.

A r s y e t i m

Ankuesja, Valdete Halimaj, ka qenë e punësuar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në pozitën -Zyrtare ligjore për licencim. Në bazë të vendimit nr. 699 të datës 09.12.2011, Komisioni disiplinor i shqipton masën disiplinore ndërprerje e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil pa e dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension. Kundër këtij vendimi, ankuesja ka paraqitur ankesë nr. 15 të datës 04.01.2012. në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave. Komisioni ka vërtetuar Vendimin nr. 699 të datës 09.12.2012 i nxjerr nga Komisioni disiplinor si i bazuar, pa arsyetimin e vendimit. Ankuesja ka paraqitur ankesë nr. 269 të datës 29.02.2012 në Këshillin Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore, se Komisioni disiplinor ka nxjerr vendim kundërligjshëm, pa argumentuar dhe pa prova të besueshme.

Këshillin Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, në bazë të vendimit nr. 02/36/2012 të datës 05.04.2012, ka obliguar organin e punësimit- Ministrisë e Tregtisë dhe Industrisë **Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave**, që ta rishqyrtoj ankesën **nr. 15 të datës 04.01.2012** të ankueses, në pajtim me nenin 84, 85 dhe 86 të Ligjit nr. 02/L-28 për Procedurat Administrative, në afat prej 15 ditësh ta merr vendimin meritor për këtë çështje.

Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me shkresën nr. 1747/2012 të datës 27.04.2012 e ka njoftuar Këshillin për nxjerrjen e vendimit, siç ka qenë i obliguar nga Kolegji i Këshillit. Vendimi nr. 1735 i datës 27.04.2012 e ka refuzuar ankesën e ankueses si të pabazuar.

Kundër këtij vendimi, ankuesja e pa kënaqur ka paraqitur ankesë në Këshillin Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se ndaj saj janë shkelur të drejtat nga marrëdhënia e punës, dhe njëherë Këshilli të nxjerrë vendim përfundimtar lidhur me çështjen.

Baza Juridike- neni 101 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 12 të Ligjit nr. 03/L-192-Ligji për Këshillin Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 14 të Rregullores nr. 02/2011, për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës për Shërbimin Civil të Kosovës, neni 9 dhe 81 parag. 2 nenparag. 2.2. i Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-149, neni 77, i Ligjit për Procedurën Administrative nr. 02/L-28, Rregullorja nr. 04/2011 për procedurat Disiplinore, Rregullorja nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjedhjes së Kontesteve dhe Ankesave dhe Rregullorja nr. 01/2011 për Ndërprerjen, Pezullimin dhe Përfundimin e Marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil, neni 3 parag. 3.2. dhe 3.3. neni 4. parag 4.2. dhe 4.7. të Ligjit nr. 03/L-138 për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/05 për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë, neni 5 parag. 5.1. Udhëzimit Administrativ nr. 01/2010 për Organizimin dhe funksionalizimin e Zyrës së Licencimit në sektorin e naftës, neni 4 parag. 3., neni 11 parag. 1., 2. dhe 3., neni 14, neni 23 Udhëzimit Administrativ nr. 07/2010 për Përcaktimin e produkteve të naftës dhe derivateve të saj.

Përmbledhja e Fakteve- Kolegji i Këshillit, për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, administroi këto prova relevante: ankesën nr. 915/2012 të datës 21.05.2012, draft raporti i auditimit nga Zyra e Auditorit Përgjithshëm nr. 21.3.1-2011-06 të datës, mars 2012, Raporti i drejtorit i Njësisë së auditimit të brendshëm në MTI nr. 677 të datës 11.11.2011, vendimin A 02/36/2012 të datës 06.04.2012 të KPMSHCK-së, Vendimin e komisionit të ankesave nr. 1735 të datës 27.04.2012, lejen importi (kopje lejes nr. 6266 të datës 25.07.2011), ankesën nr. 269/2012 të datës 29.02.2012, Vendimin nr. 366 të datës 03.02.2012, ankesën nr. 15 të datës 04.01.2012, vendimin nr. 699 të datës 09.12.2011, vendimin për pezullim nr. 670 të datës 09.11.2011, kontrata e marrëdhënies së punës nr. 1200(2)2011 nr. i postit ZLSN/02 të datës 12.07.2011, Përgjigjen në pretendimet ankimore të ankueses nr. 1109 të datës 12.03.2012, procesverbalin nr. 52 të datës 26.01.2012, vendimin për emërimin e anëtarit të tretë të komisionit për zgjedhjen e kontesteve dhe ankesave nr. 34 të datës 05.01.2012, Vendimin për emërimin e komisionit për konteste dhe ankesa nr. 709 të datës 16.12.2011, Procesverbalin nr. 697 të datës 09.12.2011, vendimin MTI-së 625 të datës 18.11.2011, vendimin MTI-së nr. 683 të datës 18.11.2011, Deklaratë kundër vendimin për pezullimin e Valdetes Halimaj të datës 14.11.2011, draft raporti i auditimit të brendshëm për periudhën 2010-2011 të datës 11.11.2011, kopjen e procesverbalit të inspektimit të biznesit,

kërkesën për licencim, vendimin MTI-së –zyra për licencim, rregullimin dhe vëzhgimin e Sektorit të naftës në Kosovë nr. 255 të datës 11.05.2011, shkresën për rishqyrtimin e ankesës nr. 15 e datës 04.01.2012 nr. 1747 të datës 27.04.2012.

Gjatë shqyrtimit të të gjitha provave ankimore të ankueses dhe përgjigjes në ankesë të autoritetit punëdhënës me provat e shkresat e bashkangjitura, Kolegji i Këshillit, gjeti se, **ankesa nuk është e bazuar, sepse**

Vendim për pezullim, sekretarja e përgjithshme të MTI-së ka kompetenca për të marrë një vendim të tillë, sipas Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, nenit 38 parag. 1 (“Sekretari i përgjithshëm është udhëheqësi administrativ i Ministrisë dhe i raporton drejtpërdrejtë ministrit.”) dhe parag. 2 nën-parag. 2.4 (“**menaxhon nëpunësit civil dhe punonjësit tjerë të ministrisë;**”) si dhe sipas Rregullores nr. 04/2011 për Procedurat disiplinore në Shërbimin Civil, nenit 8 parag. 1 nën-parag. 1.1. (“pezullimi parandalues me pagesë deri në tre (3) muaj në pritje të një hetimi, i cili duhet të propozohet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe **miratohet nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit në institucion;**”)

Ankuesja ka pas për obligim që ta respektojë Ligjit nr. 03/L-138 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/05 për Tregtinë me naftë dhe derivatet e naftës në Kosovë, veçanërisht neni 3 paragrafin 3.2. dhe 3.3. (“3.2 Veprimtaria themelore e Zyrës së Licencim është t’i japë, t’i vazhdojë, t’i pezullojë, t’i ndryshojë ose t’i revokojë licencat në pajtim me këtë ligj. **3.3 Licencat i nënshkruan ministri.**”).

Ankuesja nuk ka pas bazë ligjore për lëshimin e lejeve të importit me nënshkrimin e vet (provë-L.EJE IMPORTI nr. 6266 të datës 25.07.2011 të cilën i ka dhanë duke shkëlur edhe nenin 7 paragrafi 3. të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2010 për Përcaktimin e Produkteve të naftës dhe derivateve të saj.)

Në nenin 52 paragrafi 2. të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-149 thuhet: “**Nëpunësit civil nuk do të bëjnë veprime apo të marrin vendime, të cilat i tejkalojnë kufijtë e rangut dhe funksioneve të tyre, përveç atyre të përcaktuara me këtë ligj.**”

Në nenin 4 paragrafi 3. të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2010 për Përcaktimin e produkteve të naftës dhe derivateve të saj thuhet: “**Dokumentacioni i bashkangjitur kërkesës, duhet të jetë në original ose fotokopje të vërtetuara në Gjykatë ose në organin kompetent.**”

Në nenin 23 të këtij Udhëzimit, paragrafi 1. thuhet: “**Zyra e licencimit mundet në bashkëpunim me Inspektoratin, të ushtroj kontroll tek subjektet e licencuara.**”

Ankuesja, sipas procesverbalit nr. 697 të datës 09.12. 2011 të Komisionit Disiplinor në MTI, nuk ka respektuar nenet të lartë cekura, ka vepruar në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësit e saj të punës, nuk ka respektuar Ligjin nr. 03/L-138 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/05 për Tregtinë me naftë dhe derivatet e naftës në Kosovë, si dhe Udhëzimin Administrativ nr. 07/2010 për përcaktimin e Produkteve të naftës dhe derivateve të saj.

Në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-149, neni 51 parag. 1 ku thuhet: “**Nëpunësit civilë i ushtrojnë detyrat e tyre në bazë të kushteve të përcaktuara me ligj dhe në përshkrimin e detyrave të punës në mënyrë të saktë, të ndërgjegjshme, të rregullt, në kohë dhe pa interes vetjak, në përputhje me interesin publik dhe në**

përputhje me sistemin juridik të Republikës së Kosovës”, si dhe nenin 51 parag. 2: “Nëpunësitë civilë janë të obliguar që të mbështesin dhe të lehtësojnë zbatimin e politikave të miratuara nga administrata publike” ku çdo kundërshtim i zbatimit të këtyre dispozitave duhet të rezultoi me ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Kolegji i Këshillit, pas analizës dhe sistemimit të provave-dëshmimeve të parashtruara nga ankueses dhe organi punëdhënës, si rezultat i të gjykuarit të tërësishëm, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit.

T'i dorëzohet: Ankueses Valdete Halimaj, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë Menaxherit të Personelit në MTI dhe dosjes së lëndës ankimore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda nr. 02/126/2012, më 13. 06.2012



Irena S. Ahmedi
Irena S. Ahmedi